VENDIM
Nr.681, datë 5.10.2011

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.545, DATË 11.8.2011 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELEVE TË PAGAVE TË NËPUNËSVE CIVILË/NËPUNËSVE, ZËVENDËSMINISTRIT DHE NËPUNËSVE TË KABINETEVE, NË KRYEMINISTRI, APARATET E MINISTRIVE TË LINJËS, ADMINISTRATËN E PRESIDENTIT, KUVENDIT, KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE, PROKURORINË E PËRGJITHSHME, DISA INSTITUCIONE TË PAVARURA, INSTITUCIONET NË VARËSI TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE/KRYEMINISTRIT, INSTITUCIONET NË VARËSI TË MINISTRAVE TË LINJËS DHE ADMINISTRATËN E PREFEKTIT""

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 18 e 29 të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 "Statusi i nëpunësit civil", të nenit 4/2 të ligjit nr.10 405, datë 24.3.2011 "Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve", të ligjit nr.9584, datë 17.7.2006 "Për pagat, strukturat dhe shpërblimet e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj" dhe të ligjit nr.10 355, datë 2.12.2010 "Për buxhetin e vitit 2011", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pika 4/2 e vendimit nr.545, datë 11.8.2011 të Këshillit të Ministrave, ndryshohet, si më poshtë vijon:

"4/2. Në Kryeministri, pozicionet "Drejtor i Departamentit të Legjislacionit dhe Koordinimit", "Drejtor i Departamentit të Kontrollit të Brendshëm Administrativ dhe Antikorrupsionit" dhe "Drejtor i Departamentit të Bashkërendimit të Strategjive dhe Koordinimit të Ndihmës së Huaj", në masën 8 000 (tetë mijë) lekë; pozicionet "Jurist në Departamentin e Legjislacionit dhe Koordinimit", "Koordinator pranë sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave", "Inspektor në Departamentin e Kontrollit të Brendshëm Administrativ dhe Antikorrupsionit" dhe "Koordinator në Departamentin e Bashkërendimit të Strategjive dhe Koordinimit të Ndihmës së Huaj", në masën 10 000 (dhjetë mijë) lekë në muaj.".

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, për vitin 2011, të përballohen nga fondet e planifikuara për Kryeministrinë, po për vitin 2011.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha